



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
DREJTORIA PERGJEGJESE PER PYJET DHE KULLOTAT

Nr 14057/3 prot

Pukë, më 20.10.2023

PROJEKT-VENDIM
NR. 5, Date 20.10, 2023

Per dhenien e dakortesise per vijimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor/kullosor publik per 0.0289 ha per ndertimin e impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike 2MW nga SHOQËRISË "ROI ENERGY" Sh.p.k

Bazuar ne Ligjin nr. 139 date 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore". Ligjin nr.8480, date 27.05.1999 "Per funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike", Ligjin nr.107/2014 date 31.07.2014 "Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit", ne Ligjin nr.10304 , date 15.07.2010 "Per sektorin minerar ne Republiken e Shqiperise", ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr. 433 date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te Bashkive te fondit pyjor e kullosor publik....", ne VKM nr. 591, date 9.10.2018, "Per disa ndryshime ne VKM nr 1353, date 10.10.2008 "Per rregullat dhe paraqitjen e kerkeses, mbajtjen e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogelimit te siperfaqes dhe te vellimit te fondit pyjor", ne VKM nr. 592, date 09.10.2018 "Per disa ndryshime ne VKM nr. 1374, date 10.10.2008 "Per percaktimin e rregullave dhe te procedurave qe ndiqen per heqjen, shtimin dhen dryshimin e destinacionit te fondit kullosor" Udhezimin e Ministris te Mjedisit Nr. 1 date 09.06.2016 "Per rregullat, procedurat e kerkimit, te shqyrtimit e miratimit te kerkeseve per dhenie ne perdorim te fondit pyjor dhe kullosor publik", nga ana Drejtoria Pergjegjese per pyjet dhe Kullotat .Me propozim te Kryetarit te Bashkise Keshilli Bashkiak pas shqyrtimit

VENDOSI:

1. Te shprehe dakortesine per vijimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor/ kullosor publik per ndertimin e impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike 2MW te siperfaqes prej 0.0289 Ha, ne ngastren 14/C ne ekonomine "Gomsiqe" te Bashkise Puke
2. Siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjor jane percaktuar ne raportin mbi studimin tekniko-ekonomik per dhenje/heqje nga fondi pyjor per ndertimin e impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike
3. Per vazhdimin e procedurave sipas percaktimeve te Udhezimit nr 2/2016 te Ministrise e Turizmit dhe Mjedisit ngarkohet Struktura Drejtoria Per pyjet dhe Kullotat ne Bashkine Puke zyra kadastres pyjore,

4. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Kryetari Bashkise dhe Drejtoria Pergjegjese Per pyjet dhe Kullotat, zyra kadastres pyjore
5. Ky vendim hyn ne fuqi sipas nenit 55 pika 6,e ligjit nr 139/2015"Per veteqeverisjen vendore"

HARTUESI

Ing Shkelzen Sulejmani



JURISTI

Aida Sinani



KRYETARI

RROK DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
DREJTORIA PERGJEGJESE PYJEVE DHE KULLOTAVE

Nr. 1457/14 prot

Pukë, më 20/10/2023

RELACION

PER MIRATIMIN ME SHKRIM PER VIJIMIN E PROCEDURAVE TE HEQJES NGA FONDI PYJOR PUBLIK TE NJE SIPERFAQE PREJ 0.0289 HA NGA ANA MINISTRISE TURIZMIT DHE MJEDISIT PER NDERTIMIN CENTRALIT ELEKTRIK EOLIK NGA SHOQERIA "ROI ENERGY" Sh.p.k

DREJTUAR :Keshillit Bashkiak Puke

Te nderuar keshilltare

Administrimi I fondit pyjore kullosore ne Bashkine Puke eshte nje nga funksionet I percaktuar ne nenin 27 te ligjit nr 139/2015 "Per veteqeverisjen vendore" ku ne piken 5 te ketij neni percaktohen funksionet e Bashkive ne fushen e Bujqesise zhvillimit rural pyjeve dhe kullotave publike ,natyres dhe biodiversitetit .Bashkite jane pergjegjese per kryerjen e ketyre funksioneve:pika 5 administrimi I fondit pyjore dhe kullosor eshte ligji nr 57/2020 si dhe aktet nenligjore ne zbatim te tij ,ne zbatim te neneve 15 dhe 17 te ketij ligji ka dale udhezimi I Ministrise Mjedisit nr 01 date 09.06.2016"Per caktimin e kriterëve per dhenje/heqje ne perdorim te fondit pyjore.

Bazuar ne udhezimin e mesiperme dhe ne kerkesen e bere nga ana shoqerise " ROI ENERGY" Sh.p.k drejtuar Bashkise Puke nr 1457 date 08.08.2023 Per marrje ne perdorim dhe heqjen nga fondi pyjor te siperfaqes pyjore qe preken nga ndertimi e impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike dhe veprave ndihmese pas marrjes se miratimit paraprak per vashdimin e procedurave nr 2027/1 date 17.03.2023 afati I vleshmerise 12 muaj nga ana Ministrise se Infrastruktures dhe Energjise në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar shtrihet ngastrat/nëngastra 14/C „bëjnë pjesë në ekonominë pyjore/kullosor "Gomsiqe" dhe eshte në pronësi/administrim të te Bashkise Puke ne baze te V.K.M. nr 433 date 08.06.2016 ne baze te kerkeses drejtuar Bashkise Puke me shkresen date

17.03.2023 ku kerkohet pergatitje e raportit tekniko-ekonomik te vleresimit financiar per ndertimin impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike. Pas marrjes se kerkese nga ana Bashkise Puke eshte ngritur grupi I punes perbere nga dy injinieret pyjeve dhe eshte shkuar ne terren dhe eshte percaktuar qarte gjurma ne te cilen do te ndertohet impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike ne bashkine Puke dhe eshte hartuar raporti tekniko-ekonomik I vleresimit financiar ku dhe jane percaktuar siperfaqet pyjore qe do te jepen ne perdorim dhe siperfaqet qe do te hiqen nga fondi pyjor kullosor dhe volume I materialit drusore qe do te demtohet nga punimet turbine eolike eshte nje aerogenerator (turbine ere) me fuqi prej 2MW.. Duke u bazuar ne V.K.M nr 591 date 09.10.2018 per disa ndryshime per vendimin nr 1353 date 10.10.2008 te keshillit te ministrave "Per percaktimin e rregullave per paraqitjen e kerkeses mbajtjes dhe plotesimit e dokumentacionit teknik,si dhe te kritereve e procedurave te zvogelimit te siperfaqes e te vellimit te fondit pyjore" te ndryshuar pika ç kerkohet miratimi me shkrim per vashtimin e procedurave te heqjes nga fondi pyjor me vendim te keshillit Bashkiak Brenda territorit administrative te cilit eshte siperfaqja pyjore e cila do ti nenshtrohet procedurave te heqjes nga fondi pyjor nga ana Ministries Turizmit dhe Mjedisit Ne menyre te permbledhur per heqjen nga fondi pyjore jane keto siperfaqe pyjore ne keto ekonomi pyjore ne territorin e Bashkise Puke

- Ekonomia Pyjore "Gomsiqe" parcela nr 14/C siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjore eshte 0.0289 ha ku do te ndertohet bazamenti I shtylles eolike

Duke ju falenderuar ju ftojme ne miratimin e project vendimit per vijimin procedurave nga ana Ministrise Turizmit dhe Mjedisit ku kerkohet miratimi me shkrim nga ana keshillit Bashkiak per vijimin e procedures se heqjes nga fondi pyjor kullosor

HARTUESI
Shkelzen Sulejmani



REPUBLIKA E SHQIPËRIE
BASHKIA PUKE
DREJTORIA PËRGJEGJESE PËR PYJET DHE KULLOTAT

Nr 1622 Prot

Puke më 07.09.2023

URDHER
NR 361 DATE 07/09/2023

PER

**PERGATITJE TE RAPORTIT TEKNIKO -EKONOMIK PER VENDOSJEN E IMPJANTEVE
GJENERUES TE ENERGJISE ELEKTRIKE NGA SUBJEKTI "ROI ENERGY" Sh.p.k**

Bashkia Puke ne zbatim te ligjit nr 139 te vitit 2015 neni 8 per vete qeverisjen vendore, ne baze te ndarjes se re administrative dhe V.K.M nr 433 date 08.06.2016 per transverimin ne pronesi te Bashkive te pyjeve dhe kullotave publike, sipas listes se inventarit, dhe aktualisht ne administrim te Ministrise Mjedisit e te ish komunave/Bashkive, dhe kerkesen se shoqerise "ROI ENERGY" Sh.p.k . date 09.08.2023 per pergatitjen te raportit tekniko-ekonomik per ndertimin e impjantit gjenerues te energjise elektrike eolike zona Kcire territorin e Bashkise Puke.

URDHEROJ

Te ngrihet grupi i punes si me poshte:

- ❖ Ing Astrit Hyseni
- ❖ Ing Shkelzen Sulejmani

1. Grupi i punes per verifikimin ne terren sipas kerkesen se shoqerise "ROI ENERGY" Sh.p.k date 09.08.2023..
2. Te hartoje raportin tekniko-ekonomik per siperfaqet e fondit pyjor qe do te jepen me kontrat qiraje/perdorimi dhe dhe siperfaqja qe do te hiqet nga fondi pyjor dhe materiali drusor
3. Te hartohet projekt vendimi per keshillin Bashkiak
4. Ky urdher hyn ne fuqi menjehere!

KRYETARI I BASHKISE

RROK DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE
Drejtoria Përgjegjëse për pyjet dhe kullotat

Nr. 1457/prot:

Puke, me 20.10.2023

URDHËR
Nr. 513, Datë 20.10.2023

**PËR MIRATIMIN E STUDIMIT TEKNIKO EKONOMIK
DHE VIJIMIN E PROCEDURAVE PËR DHËNJE NË PËRDORIM/HEQJE NGA FONDI
PYJOR PUBLIK TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 0.0729 HA QË NUK NDRYSHONË
KATEGORINË E PËRDORIMIT NË FUNKSION PER VENDOSJEN E EREMATESVE PER
STUDIMIN E ERES PER VENDOSJE AEROGJENERATOREVE,
NGA SHOQERIA "ROI ENERGY" SH.P.K**

Në mbështetje të ligjit 139 viti 2015 "Për organizimin dhe funksionimin e pushtetit vendor 57/20 "Për pyjet të ndryshuar, të V.K.M nr. 1353, datë 10.10.2008 "ndryshuar" Udhezimin nr 1 date 09.06.2016 Për rregullat, procedurat e kerkimit ,te shqyrtimit e miratimit te kerkesave per dhenje ne perdorim te fondit pyjore dhe kullosor pika 10 e ketij udhezimi Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si mësipër kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë Puke

URDHËROJ:

1. Vijimin e procedurave që duhet të ndjekë Drejtoria përgjegjëse për pyjet në bashkinë Puke për dhenjen ne perdorim/heqje të një sipërfaqeje prej 0.0729 ha ne ngastrat/nëngastra 14/c , bën pjesë në ekonominë pyjore/kullosor "Gomsiqe"
2. Shoqëria "ROI ENERGY" SHPK, duhet të rehabilitojë sipërfaqet objekt studimi sipas planit të rehabilitimit dhe lejes mjedisore si dhe të pyllëzojë me drurë pyjorë, brenda vitit të parë, një sipërfaqe prej 0.2187 ha sipas marrëveshjes me Bashkinë Puke .
3. Drejtoria Përgjegjëse Pyjeve dhe Kullotave në bashkinë Puke, në prani të përfaqësuesve të shoqërisë:
 - a. shënojë në terren poligonin me sipërfaqen pyjore objekt i perdorimit per vendosje aerogjeneratoresh bëjë vlerësimet në volum e vlerë për lëndën drusore dhe pasuritë e tjera pyjore që janë hequr gjatë kryerjes së punimeve dhe mbajë aktet përkatëse,
 - b. monitorojë në vite detyrimet përkatëse dhe kryerjen e procedurave në terren për reabilitimin, pyllëzimin dhe ripyllëzimin e sipërfaqevenë përdorim.
4. Shoqëria të kryejë pagesat e menjëhershme në llogarinë rrjedhëse të Bashkisë Puke, sipas tarifave të përcaktuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.559, datë 29.07.2022 "Për

përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, dhe pasuritë e tjera pyjore që janë hequr gjatë kryerjes së punimeve dhe tarifën e përdorimit për vitin e parë e në vijim.

5. Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, bën çregjistrimin e sipërfaqes pyjore publike të identifikuar sipas lidhjes 1 (një) të këtij vendimi, nga kategoria “Tokë e zënë pyjore” dhe e regjistron në kategorinë “Tokë e zënë, object për aerogjeneratoresh. Te behen ndryshimet në regjistrin kadastral për sipërfaqet pyjore
6. Për zbatimin e këtij Urdhëri ngarkohet Drejtoria Përgjegjëse Pyjeve dhe Kullotave pranë Bashkisë Puke,

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Ju faliminderit për bashkëpunimin!

KRYETARI I BASHKISË

RROK DODAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKE

Drejtoria Përgjegjëse Për Pyjet dhe Kullotat

Nr. 1457/1 prot

Pukë, më 20 10. 2023

RAPORT

**MBI STUDIMIN TEKNIKO - EKONOMIK PËR DHËNIE NË PËRDORIM / HEQJE NGA FONDI
PYJOR PËR NDERTIMIN E IMPIANTIT GJENERUES TE ENERGIJISE ELEKTRIKE EOLIKE
NGA SHOQËRISË "ROI ENERGY" Sh.p.k**

Bazuar në kërkesen e shoqërisë "ROI ENERGY" Sh.p.k nr 1457 date 08.08.2023 për ndertimin e impiantit gjenerues te energjise elektrike colike 2MW dhe veprave ndihmese dhe Urdhërin të kryetarit të bashkisë Nr 361 date 07.09.2023 për vlerësimin tekniko-ekonomik të sipërfaqes pyjore/kullosore ndertimin e impiantit gjenerues te energjise elektrike eolike 2MW , grupi I punës I përbërë nga ing Shkelzen Sulejmanii , ing Astrit Hyseni studioi kërkesën e subjektit shoqërisë "ROI ENERGY" Sh.p.k dhe realizoi verifikimin në terren dhe në regjistrin kadastral të sipërfaqeve pyjore dhe kullosore object I ndertimin e impiantit gjenerues te energjise elektrike eolike 2MW Mbështetur në të dhënat e regjistrit kadastral pyjor/kullosor rezulton që sipërfaqja e kërkuar shtrihet ngastrat/nëngastra 14/c bën pjesë në ekonomitë pyjore/kullosor "Gomsiqe" dhe janë në pronësi/administrim te Bashkise Puke ne baze te V.K.M. nr 433 date 08.06.2016 Përshkrimi parcelar I sipërfaqes object studimi dhe kategoria e përdorimit të saj,pasqyrohen në tabelën 1 dhe 2 të këtij raporti.

Nga verifikimi në terren rezulton kjo gjendje: ka ndryshime me te dhenat e regjistrit katestral. Ndërhyrjet e propozuara që pasqyrohen në dokumentacionin e paraqitur nga Shoqëria "ROI ENERGY" Sh.p.k ndryshojnë kategorinë e përdorimit të territorit, funksionin, formën e qeverimit dhe treguesit kryesorë të grumbujve,nga kjo sipërfaqe 0.0289 ha do te hiqet nga fondi pyjor pasi do te ndertohen bazamentet e impiantit/ turbinave colike dhe konkretisht ne nengastren nr 14/c Ndersa nuk ndryshojne kategorin e perdorimit dhe rikthehen ne gjendjen e mepershme sip 0.044 ha dhe 0.8 km trase e qe do te kthehet ne gjendje eksistuese qe perfshihen ne parcelen 14/c bëjnë pjesë në ekonomitë pyjore/kullosor "Gomsiqe" dhe janë në pronësi/administrim të te Bashkise Puke ne baze te V.K.M. nr 433 date 08.06.2016

Procedurat që ndiqen për dhënien në përdorim/heqjen nga fondi pyjor dhe kullosor publik janë të mbështeturane V.K.M-ve nr 1353,datë 10.10.2008,të ndryshuar"Për rregullat për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, kriteret dhe procedurat e zvogëlimit të sipërfaqes dhe të vëllimit të fondit pyjor",

Pas miratimit të raportit tekniko-ekonomik dhe akteve të tjera normative si mësipër,shoqëria "ROI ENERGY" Sh.p.k kryen aktivitetin për sipërfaqen e shpallur, vetëm pas lidhjes së kontratës me bashkinë Puke dhe likujdimit të tarifës prej **1.131.754 leke**

Tarifat e dhënies në përdorim/heqjes nga fondi pyjor kullosor bazohen në VKM-ve nr. 559, datë 29.07.2022 "Përpërcaktimin e cmimeve tarifave për dhenjen në shfrytëzim/Përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore këto bazohen në afatin kohor sipas grafikut të punimeve të miratuar nga institucioni përkatës dhe kategorinë e përdorimit. Shuma në lek/vit konsistonnë:

1. Vlera e përdorimit për sipërfaqen e dhene hiqen/jepen përdorim
Toke me bimesi pyjore cunqishte 0.0726 ha x 192.000 lek = 13.996 lekë
2. Vlera e përdorimit për linjat
Cunqishte 5.526 km x 190.000 lek = **1.049.940** lekë
3. Vlera e përdorimit rruges trase e re
cunqishte 0.8. km x 50.000 = 40.000 leke

Vlera e bimesise pyjore,flores dhe faunes perbehet nga:

Vlera lendes punimit 8.2 x 4000 = 32.800

Vlera e drureve te zjarrit 15m³ x 600 = 9000 leke

PERPILUESIT E RAPORTIT TEKNIKO -EKONOMIK

Ing Shkelzen Sulejmani



Ing Astrid Hyseni



MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
RROK DODAJ



BASHKIA PUKE
DREJTORIA PERGJEGJEJE PER PYJET DHE KULLOTAT

PASQYRE EPERSHKRIMIT PARCELAR SIPAS REGJISTIT KADASTRAL
PER VENDOSJEN E EREMATESVE PER STUDIMIN E ERES DHE PER VENDOSJE AEROGENERATOREVE

Nr	EKONOMIA PYJORE	NGASTRA	PERBERJA E GRUMBULLIT	FUNKSIONI	FORMA QEVERISJES	TE DHENAT TE GRUMBULLIT PYJORE							FUQIA LENDORE	
						MOSHA	K.D	DIAMI mes	LART mes	filizerja	NEN/ PYLL	Kati	PER/ HA	TOTAL
1	Gomsiqe	14/C	10 bung	prodhues	cungshite	30	0.8	14	8	-	Definj fier		47.5	950

Ing. Astrit Hyseni



Ing. Shkelzen Sulejmani



BASHKIA PUKE
DREJTORIA PERGJEGJESE PER PYJET DHE KULLOTAT

INVESTIME TE KRYERA NE VITE
PER VENDOSJEN E EREMATESVE PER STUDIUMIN E ERES DHE PER VENDOSJE AEROGJENERATOREVE

Nr	PERDORIMI	EKONOMIA PYJORE	NGASTRA	SIPERFAQJA TOTALE HA	SIPERFAQJA ME PUNIME	VITI I KRYERJES SE PUNIMEVE	PUNIMI I KRYER NE HA/M3			VLERA E INVESTIMIT 000/LEKE
							Punim	Permitres	Sistemabore	
1	prodhues	Gomsiqe	14/C	20	=	=	=	=	=	=

Ing/ Astrit Hysemi



Ing/ Shkelzen Sulejmani



BASHKIA PUKE
DREJTORIA PËR GJEGJËJESE PËR PYJET DHE KULLOTAT

PASQYRE E PËRSHKRIMIT PARCELAR SIPAS VERIFIKIMIT NE TERREN
PËR VENDOSIEN E EREMATESVE PËR STUDIUMIN E ERES DHE PËR VENDOSJE AEROGJENERATOREVE

Nr	EKONOMIA PYJORE	NGASTRA	PËRBERIA E GRUMBULLIT	FUNKSIONI	FORMA QEVERISJES	TE DHENAT TE GRUMBULLIT PYJORE					FUQIA LENDORE			
						Mosha	K.D	DIAMI mes	LART mes	filzeri a	NEN PYLL	KATE T	PER HA	TOTAL
1	Gomsiqe	14/C	10 bung	prodhues	cungishite	30	0.8	14	8	-	Delini/ fer	-	47.5	950

Ing Astrit Hyseni



ing Shkelzen Sulejmani



BASHKIA PUKE
DREJTORIA PËRGJEGJESE PËR PYJET DHE KULLOTAT

LISTA E NGASTRAVE DHE NENGASTRAVE TE FONDI PYJOR DHE KULLOSOR PUBLIK QE HIQEN /JEPEN NE PERDORIM
PER VENDOSIEN E EREMATESVE PER STUDIUMIN E ERES DHE PER VENDOSIE AEROGJENERATOREVE

NIR	EKONOMIA PYJORE kullimore	NGASTRA	Sipërfaqjaqehiqet Ngafondipjor / Kullosor ne m ²	Numri turbinave	Sipërfaqjaqejepet ne Perdorim nga fondi Pyjor/kullosor ne ha	GJATESIA NE PERDORIM KM	
						RRUGE E RE	LINIE
1	Gomsiqe	14/c	0.0289	1	0.044	0.8	5.526

Ing Astrit Hyseni



Ing Shkelzen Sulejmani



BASHKIA PUKE
STRUKTURA PËRGJEGJEJE PËR PYET DHE KULLOTAT

TABELA PËRMBLEDHËSE E VLËRESIMIT FINANCIAR
PËR VENDOSIEN E EREMATESVE PËR STUDIUMIN E ERES DHE PËR VENDOSIJE AEROGENERATOREVE

PERDORIMI I TERRITORIT	SIPERFAQJA HA	BASHKIA PUKE	VOLUMI M ³ SIPAS ASORTIMENTEVE	VLERA /LEKE		Gjatesia linjes /km	TARIFA DHENJES NE PERDORIM			SHUMAI	TOTALI LEKE
				LEK/M ³	SHUMAI 1 ^{te}		1	2/5	6/10		
0	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
BIMESI PYJORE	=	D.zjarrt	15	600	9000	=	=	=	=	9000	9000
	=	L.Punimt	8,2	4000	=	=	=	=	=	32.800	32.800
CUNGISHTE	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=
	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=
	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=
	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=
SHKURRE	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=
	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=
	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=
Linje/ km	=	=	=	=	=	5,526	190.000	=	=	1.049.940	1.049.940
BIMESI PYJORE CUNGISHTE	=	=	=	=	=	0,0729	192.000	=	=	13.996	13.996
IMPRDUKTIVE	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=
BIME MUJESORE MEDICIO	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=
RRUGE/km	=	=	=	=	=	0,8	50.000	=	=	40.000	40.000
INVESTIME REALIZUARA	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=
GIITHSEJT	=	=	=	=	=	=	=	=	=	=	1.131.754

Ing Astrit Hyseni

Ing Shkelzen Sulejmani

09.08.23
Drejt. + yjeve
z. Astina Agosaj
z. y. Aidan selc. Juncela
Pau operues
[Signature]

1457
09.08.23
[Stamp: REPUBLIC OF ALBANIA, BASHKIA PUKU]

SHOQERIA "ROI ENERGY" SHPK

ADRESA : Tirane Rruga Llazi Miho, Nr.%, Misto Mame

NIPT : M114412037D

Tirane me 04.08.2023

SHKRESE

DREJTUAR : BASHKIA PUKU

LENDA : Kerkese per marrje ne perdorim dhe heqje nga fondi pyjor per ndertimin e impiantit gjenerues te energjise elektrike eolike 2MW dhe veprave ndihmese ne vendin e quajtur Zona e Kcires, ndodhur ne Qarkun Shkoder, bashkia Puke.

Shoqeria "ROI ENERGY" SHPK, shoqeri e themeluar dhe qe ushtron aktivitetin sipas ligjeve te Shqiperise , me NIPT M114412037D me seli ne adresen Tirane Rruga Llazi Miho, Nr5, Misto Mame me administrator Klevis Ziso.

Ne perputhje me percaktimet ligjore te V.K.M Nr.822 date 07.10.2015 "Per miratimin e rregullave dhe procedureve te ndertimit te kapaciteteve te reja prodhuese te energjise elektrike, qe nuk jane objekt konçensionimi" me date 10.11.2022 Nr.8659 Prot esht pajisur me Miratimin Paraprak per vazhdim procedure per ndertimin e impiantit gjenerues te energjise elektrike eolike 2MW dhe veprave ndihmese ne zonen e Kçires, Bashkia Puke, Qarku Shkoder.

Investimi i shoqerise "ROI ENERGY" Shpk eshte perzgjedhur te zhvillohet ne zonat ideale per te ndertuar pasi nuk ben pjese ne asnje nga kategorite e zonave te penguara. Vendodhja e Turbines se eres se parashikuar eshte percaktuar nga sistemi i koordinatave ne plan Gaus-Krueger.

Zona ne fjale , persa l perket realizimit te turbines eolike, rezulton e arritshme nepermjet akseve rrugore ekzistuese. Keto akse rrugore do te perdoren si per fazen e ndertimit te turbines ashtu dhe per fazen e transporteve te "jashtezakonshme" qe organizohen per dergimin e te gjithe komponenteve elektro mekanin te turbines se eres deri ne sheshin perkates te seciles prej tyre.

Bazuar ne :

1. Nenin 17 te ligjit nr.9385 date 04.05.2005 "Per pyjet dhe sherbimin pyjor" te ndryshuar.

2. VKM nr.1353 date 10.10.2008 "Per percaktimin e rregullave te paraqitjes kerkeses, mbajtjes dhe plotesimit te dokumentacionit teknik, si dhe te kriterëve te procedureve te zvogelimit te siperfaqes te vellimit te fondit pyjor.

Shoqeria esht duke aplikuar prane Bashkise Puke per te realizuar marrjen ne perdorim dhe heqjen e nje pjese nga fondi pyjor te siperfaqes mbi te cilin shtrihet objekti.

Te dhenat

KERKUESI : SHOQERIA "ROI ENERGY" SHPK

VEPRIMTARIA: Projektim ,ndertim,mirembajtje e impianteve gjenerues te energjise elektrike.

VENDODHJA : Tirane,rruga Misto Mame

EKONOMIA PYJORE: GOMSIQE

SIP PER HEQJE : 289.8 M2

SIP PER PERDORIM : 0.440 Ha

Bashke lidhur jane :

- 1.CD me te gjithe dokumentacionin
- 2.Lista e detajuar me parcelat ku shtrihet projekti
- 3.Planimetria e gjeoreferuar me hartat pyjore
- 4.Miratimi Paraprak I shoqerise (Per Vazhdim Procedure) me 10.11.2022
Nr.8695 Prot leshuar nga Ministria e Infrastruktures dhe Energjise .
- 5.Licensat e studio se projektimit
- 6.Ekstrakt
- 7.Raporti i Vleresimit te Ndikimit ne Mjedis
- 8.Relacioni Teknik
- 9.Projektin e ndertimit
- 10.Dakortesine per miratimin ne parim te project-propozimit te cituar ne praktiken e shoqerise leshuar nga Bashkia Puke.

DUKE JU FALENDERUAR PER BASHKEPUNIMIN !

SHOQERIA "ROI ENERGY" SHPK

ADMINISTRATOR

KLEVIS ZISO





REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË

Në mbështetje të Ligjit Nr. 43 datë 30.04.2015 "Për sektorin e energjisë elektrike", i ndryshuar dhe V.K.M. Nr. 822 datë 07.10.2015 "Për miratimin e rregullave dhe procedurave të ndërtimit të kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë elektrike, që nuk janë objekt koncesioni", e ndryshuar, i jepet:

SHOQËRISË "ROI ENERGY" SH.P.K. MIRATIM P A R A P R A K

(PËR NVAZHDIM PROCEDURE)

Nr. 2027/, datë 17.02.2023

"Për ndërtimin e impiantit gjenerues të energjisë elektrike eolike me kapacitet të instaluar 2 MW, dhe veprave ndihmëse, në Zonën e Kcirës, Bashkia Pukë"

ZËVENDËS MINISTRI



ILIR BEJTJA

Afat i vlefshmërisë: 12 muaj